



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. Mentor Hyseni, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. Hajrije Morina, drejtoreshë;
 - 2.3. Seat Bilibani, drejtor, dhe
 - 2.4. Idriz Maliqi, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes KRU "Prishtina" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	27.3.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
i nderuar zëvendëskryeministër Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, **i propozoj Qeverisë ta shkarkojë Bordin e Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit “Prishtina” për shkelje të detyrave fiduciare.**

Sipas ligjit, Qeveria duhet të shkarkojë drejtorët kur ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.¹ Siç kemi vënë re në raste të mëparshme, termi *detyrë fiduciare* përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj. Në rastin e KRU Prishtinës, Qeveria ka tri arsye kryesore për të shkarkuar Bordin: (1) shpërfillja e humbjeve të shkaktuara nga kryeshefi; (2) mosadresimi i opinionit të kundër të auditimit; (3) mosadresimi i gjetjeve të auditorit të brendshëm; dhe (4) emërimi i parregullt i ushtruesit të detyrës së kryeshefit.

Më 2 prill 2019, është miratuar pagesa e ndëshkimit prej 208.000 eurosh për humbje që ndërmarrja i kishte shkaktuar një operatori ekonomik lidhur me projektin “Ndërtimi i Fabrikës në Shkabaj”. Drejtorët e tanishëm asnjëherë nuk kanë marrë masa ndaj kryeshefit për humbjen e shkaktuar.

Në qershor 2019, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka botuar raportin mbi KRU Prishtinën për vitin 2018, duke dhënë “opinion të kundërt”. Saktësisht, kur auditori jep opinion të kundërt i bie që “pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale”.² Thënë shkurt, pasqyrat fina-

1 Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), neni 19.3.

2 ZKA, Raporti i auditimit të ndërmarrjes publike Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” Sh.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, f. 7.

nciare kanë dalë të rreme. Bordi i ndërmarrjes, i emëruar po në qershor 2019, nuk ka marrë masa ndaj zyrtarëve përgjegjës për pasqyrat financiare. Ky mosveprim përbën “arsye për të besuar” se Bordi ka shkelur detyrat ndaj ndërmarrjes.

Më 31 janar 2020, auditori i brendshëm ka konstatuar se ndërmarrje ka dështuar të zbatohet 87 nga 90 rekomandimet e dhëna.³ Raporti vë barrën e dështimit mbi bordin.

Më 10 mars 2020, kryeshefi i ndërmarrjes ka dhënë dorëheqje, pasi Bordi ka vlerësuar punën e tij si të pakënaqshme. Bordi po atë ditë ka nxjerrë dy vendime: një për të miratuar dorëheqjen dhe një për të emëruar ushtrues detyre të kryeshefit një person të tretë, ani pse ndërmarrja ka zëvendëskryeshefin e vet.

Lidhur me rastin, më 12 mars, më është drejtuar me shkrim drejtori i Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, që vepron në kuadër të Ministrisë. Njësia vlerëson se dy vendimet e Bordit janë në kundërshtim me frymën e ligjit dhe akteve të tjera të zbatueshme. Njësia rikujton se ligjërisht zëvendëskryeshefi është zyrtar i lirë i ndërmarrjes, i cili zgjidhet në të njëjtën mënyrë si kryeshefi dhe “është përgjegjës për menaxhimin e ndërmarrjes në mungesë të Kryeshefit Ekzekutiv”.⁴ Për këtë arsye, Njësia çmon se Bordi ka gabuar duke anashkaluar zëvendëskryeshefin. Kjo rrethanë përbën arsye shtesë për të besuar se Bordi ka shkelur detyrat fiduciare.

Në fund, ambasadorë të vendeve evropiane – Zvicrës dhe Gjermanisë – që përkrahin prej kohësh sektorin e ujit kanë shprehur shqetësimin e tyre rreth ngecjeve dhe shkeljeve në implementimin e projekteve të përbashkëta me KRU Prishtinën.

Rrjedhimisht, i propozoj Qeverisë të nxjerrë vendim për të shkarkuar Bordin e Drejtorëve të KRU Prishtinës dhe për të emëruar një bord të përkohshëm, me përbërjen e shpalosur në propozim-vendim.

Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë

Bashkëngjitje (4):

- Raporti i Zyrës së Auditimit të Brendshëm, KRU Prishtina, 31.1.2020.
- Mesazh me postel nga drejtori i NjPMNP, “Njoftim për Vendimin e BD të KRU Prishtina SH.A.”, drejtuar Ministres, 12.3.2020
- Vendim 32 i BtD të KRU Prishtinës për dorëheqjen e kryeshefit, 10.3.2020
- Vendim 33 i BtD të KRU Prishtinës për emërimin e UD kryeshefit, 10.3.2020

3 Provë: Raporti i Zyrës së Auditimit të Brendshëm, KRU Prishtina, 31.1.2020.

4 Provë: Mesazh me postel nga drejtori i NjPMNP, drejtuar Ministres, 12.3.2020 (citon LNP, nenet 21.3 dhe 23.3; Kodin e etikës dhe qeverisjes korporative, pika 25.4).